	<b>MENAXHIMI I SISTEMIT SIM</b>		
	<b>POLITIKA SIM</b>		
Kodi Nr.: PSIM	Versioni: 1	Data Efektive: 16.09.2014	Faqja 1 / 2

## **ANGAZHIMI NDAJ CILËSISË, MENAXHIMIT MJEDISOR DHE SIGURISË E SHËNDETIT NË PUNË**

Menaxhimi i Lartë i kompanisë QPLAN-INE është angazhuar:

**Të** mbështesë Politikën e Cilësisë, Mjedisit dhe Sigurisë e Shëndetit në Punë;

**Të** zbatojë procesin e përmirësimit të vazhdueshëm;

**Të** përcaktojë dhe rishikojë objektivat e Cilësisë. Mjedisit dhe Sigurisë e Shëndetit në Punë duke i konsideruar ato si udhërrëfyese në aktivitetin e kompanisë;

**Të** jetë përgjegjës për cilësinë e punës dhe të performojmë kapacitetin më të mirë gjatë gjithë kohës;

**Të** vlerësojë parimet e solidaritetit sociaö dhe t'i përfshijë ato në përqasjen ndaj Cilësisë, Mjedisit e Sigurisë e Shëndetit në Punë.

## **KOMUNIKIMI**

**Do** të komunikojmë politikën tonë tek klientët, punonjësit, furnizuesit dhe vizitorët tanë;

**Do** të kërkojmë inputet e tyre për të mundësuar përbushjen e kërkesave dhe pritshmërive;

**Do** të nxitim këtë politikë në mënyrë aktive në të gjitha nivelet e punonjësve tanë;

**Do** të inkurajojmë ata, që të zgjedhin cilësinë, kujdesin mjedisor dhe sigurinë e shëndetin në punë si zotimin e tyre personal;

**Do** të raportojmë ndikimet mjedisore dhe aksidentet ne pune dhe do të jemi të angazhuar në zbatimin e një kulture të hapur raportuese dhe sigurie;

**Do** të nxitim transmetimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi cilësinë, mjedisin dhe sigurinë e shëndetin në punë;

**Do** të bashkëpunojmë me auditorët gjithmonë.

## **PËRMIRËSIMI I VAZHDUESHËM**

Ne do të përpiqemi vazhdimisht të përmirësojmë cilësinë, kujdesin mjedisor dhe sigurinë e shëndetin në punë nëpërmjet të mësuarit, ndarjes së informacionit, krahasimit, ndryshimit dhe pjesëmarrjes në programet e përmirësimit të vazhdueshëm.

Angazhimi ynë ndaj Cilësisë, Mjedisit dhe Sigurisë e Shëndetit në Punë do të sigurojë një kornizë, e cila do të nxitë programet tona të cilësisë dhe do të rrënjosë një kulturë cilësie dhe sigurie për përsosmëri, ndryshim dhe përmirësim të vazhdueshëm.


Ne do të zbatojmë vazhdimisht kontrollet e përshtatshme dhe do të kryejmë rishikime periodike mbi arritjen e objektivave të vendosura.

## **OBJEKTIVAT E CILËSISË**

Objektivi Kryesor i kompanisë QPLAN-INE është sigurimi i cilësisë së shërbimeve për klientët duke përbushur dhe tejkaluar pritshmëritë.

Kompania QPLAN-INE zbaton një Politikë Cilësie për të arritur objektivat e mëposhtëm:

- **SIGURIMI I KËNAQËSISË** së klientit. Përbushja dhe tejkalimi i pritshmërive të tij.
- **RENDITJA TË PARËT** në prodhimin me fushën e kosulences per sistemet e menaxhimit ISO.
- **MBËSHTETJA TEKNIKE**. Sigurimi i një shërbimi me cilësi të lartë duke respektuar të gjitha normat dhe ligjet e shtetit shqiptar.
- **PËRMIRËSIMI I VAZHDUESHËM** i cilësisë së shërbimit dhe efiçencës së proceseve.
- Krijimi i një **MJEDISI TË NXITËS** dhe **KRIJUES**, që respekton idetë e reja dhe punën.

	<b>MENAXHIMI I SISTEMIT SIM</b>		
	<b>POLITIKA SIM</b>		
Kodi Nr.: PSIM	Versioni: 1	Data Efektive: 16.09.2014	Faqja 2 / 2

### **OBJEKTIVAT MBI MENAXHIMIN MJEDISOR dhe SIGURINË E SHËNDETIN NË PUNË**

QPLAN-INE zbaton një Politikë për Menaxhimin Mjedisor dhe Sigurinë e Shëndetin për të arritur objektivat e mëposhtëm:

- ANGAZHIMI i vazhdueshëm për të bërë menaxhimin mjedisor, sigurinë dhe shëndetin pjesë të të gjithë aktiviteteve në vendin e punës
- Synimi për të përdorur KËRKESAT LIGJORE mbi menaxhimin mjedisor, sigurinë dhe shëndetin si pikënisje për krijimin e një mjedisi të sigurve pune dhe ruajtjen e mjedisit të jashtëm të kompanisë.
- Vënia në ZBATIM e Politikës SIM
- Angazhimi për të siguruar BURIMET e duhura
- KONSULTIMI dhe BASHKËVEPRIMI ndërmjet menaxhimit të lartë dhe punonjësve për zbatimin efektiv të Politikës SIM.
- SIGURIA, që të gjithë punonjësit njohin përgjegjësitë e tyre për të identifikuar dhe eliminuar aspektet mjedisore, kërcënimet ndaj shëndetit dhe sigurisë në punë,

Menaxhimi i QPLAN-INE vlerëson, që kjo Politikë SIM duhet të njihet nga të gjithë punonjësit, si edhe nga furnizuesit dhe vizitorët. Ajo është në dispozicion të kujtqdo që e kërkon, si brenda dhe jashtë kompanisë.

**Dimitris Arapatsakos**  
**QPLAN-INE**

